



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/07/2022 Ref.: 932/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë Nr.prot.621/18D, KSHC në mbledhjen e 100-të, të mbajtur me 14.06.2022, mori:

### V E N D I M

- I. Plotësohet/ndryshohet Manuali i akreditimit; Në standardet e vlerësimit për Institucionet e Arsimit të Lartë, Kapitulli 2, nënkapitulli 2.1, paragrafi 6 i cili i referohet Mësimin dhe Mësimdhënies dhe paragrafi 10 i cili i referohet Pajisjeve dhe Hapësirave, janë obligative. Akreditimi në nivel institucional nuk mund ti jepet asnjë IAL-je nëse këta dy kapituj nuk janë përmbushur në nivel substancial apo në nivel të plotë.
- II. Plotësohet/ndryshohet Manuali i akreditimit; Në standardet e vlerësimit për programet e studimit në nivel Bachelor dhe Master, Kapitulli 2, nënkapitulli 2.2 paragrafi 3, i cili i referohet Stafit akademik, dhe paragrafi 7 i cili i referohet Infrastrukturs dhe pajisjeve, janë obligativ. Programet e studimit në nivel Bachelor apo Master nuk mund të rekomandohen për akreditim derisa nuk kanë përmbushur në mënyrë substancialle apo të plotë të dy këto fusha të përgjithshme.
- III. Obligohen Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) që në proceset e akreditimit, standardet e cekura si në pikën I dhe II të këtij vendimi të aplikohen si standarde obligative dhe të përmbushen substancialisht (së paku 70%) për të arritur rekomandim pozitiv.
- IV. Standardet e miratuara nga KSHC janë obligative nga data 01.10.2022.
- V. Vendimit i bashkëngjitet Manuali i akreditimit me ndryshime.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A R S Y E T I M

Me qëllim të avancimit të standardeve për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, KSHC ka vendosur që në proceset e vlerësimit për akreditim të futen si standarde obligative pikat specifike të cekura në dispozitiv.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë duke ju referuar zhvillimit dhe evoluimit të standardeve evropiane të cilësisë në arsimin e lartë dhe kriterëve teknike që duhet t'i përmbushë për ri anëtarësim në ENQA dhe EQAR, në mbledhjen e 100-të, të mbajtur me 14.06.2022 ka shqyrtuar nevojën për ndryshim dhe plotësimin e manualit.

Pas shqyrtimit, KSHC ka ardhur në përfundim që ky dokument duhet të plotësohet/ndryshohet në pikat që kanë të bëjnë me standardet siç u cekën më lartë.

Pas diskutimeve, KSHC-së vendosi që të procedohet për votim dhe propozimi është votuar me unanimitet të plotë.

Ndryshimi vlen për akreditimin/ri-akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për akreditimin/ri-akreditimin e programeve studimore bachelor dhe master.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura dhe qëllimin për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë ne përputhje me standardet evropiane, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.*

Vendimi iu dërgohet:

- MASHTI;
- Publikohet në web.faqen e AKA
- Arkivit të AKA-së.

  
  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë